


Nr/Br: 242/2017
Më/Dana: 16/03/2017
BOSTAN - BOSTANE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

Shkolla e Mesme Ekonomike -Novobërdë

Në bazë të nenit 11 (njëmbëdhjetë) të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr.2/2016

Drejtoria e shkollës bënë këtë:

FTESË PËR OFERTË

Ftojme të gjitha agjencitë turistike të bëjnë ofertë për eskursionin e maturantëve të Shkollës së Mesme Ekonomike në Novobërdë

Eskursioni do të zhvillohet në Republikën e Shqipërisë, prej 28 e deri më 30 prill 2017.

Kohëzgjatja e eskursionit është 3 (tri) pansione të plota.

Në eskursion do të marrin pjesë maturantët e shkollës.

Në ofertë do të përfshihet çmimi i akomodimit, ushqimi, transporti dhe shpenzimet e ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave në muze dhe kala që parashihen në rrugëtimin e eskursionit të përcaktuar nga Këshilli drejtues i shkollës.

Agjencionet turistike që konkurojnë duhet t'i plotësojnë këto parakushte:

1. Agjencioni duhet të ketë lejen e punës dhe të jetë i licencuar me të drejtë qarkullimi jashtë shtetit- Ofertës t'i bashkëngjiten fotokopjet e këtyre dokumenteve.
2. Të ketë bërë kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore-Ofertës t'i bashkëngjiten dëshmitë për këtë për të gjithë autobusët që do të përdoren në eskursion.
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e eskursionit.
4. Të ofrojë dëshmi me shkrim për akomodim në hotel në të cilin plotësohen kërkesat e Këshillit drejtues të shkollës, nxënësve dhe prindërve.

5. Duhet të ketë licencën e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i restorantit).
 6. Për tërë personat e angazhuar në eskursion nga agjencitë(shoferët) duhet të paraqiten certifikatat e mjekut.
 7. Agjencioni duhet të siguron përkujdesje mjekësore për pjesëmarrësit e eskursionit gjatë tërë kohëzgjatjes së tij. Ofertës t'i bashkëngjiten leja e punës së mjekut dhe fotokopja e kontratës me të për përkujdesje gjatë tërë kohëzgjatjes së eskursionit.
 8. Agjencionit I kërkohet ta bëjë konfirmimin me shkrim se do të jetë në gjendje të menjanojë shpejtë defektet eventuale të mjetit transportues ose, nëse është e nevojshme, pa vonesë ta zëvendësojë me mjet tjetër transporti.
 9. Afati i konkurimit 7 ditë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
 10. Dokumentat jashtë afatit të paraparë nuk pranohen.
 11. Dokumantat jo complete nuk shqyrtohen.
- Dorëzimi i ofertave bëhet deri më 22.03.2017 deri në ora 15⁰⁰ në zyrën pritëse të Komunës për DKA, kati II nr. 28 .Hapja e ofertave bëhet në të njëjtën ditë në ora 15⁰⁰ në DKA.

Novobërdë, 16.03.2017



Drejtor i shkollës:

Msc .Sami Bunjaku